

NDËRLIDHJA MIDIS AFTËSIVE NDËRPERSONALE, BURIMEVE TË MBËSHTETJES
DHE REZILIENCËS TE MËSIMDHËNËSIT

TEMA PËR TITULLIN MASTER I ARTEVE NË PROGRAMIN “PSIKOLOGJI
SHKOLLORE DHE KËSHILLIM”

Nga

VLORA KURTI



UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI FILOZOFIK

DEPARTAMENTI I PSIKOLOGJISË

Janar, 2023

Kandidatja: Vlora Kurti

Mentorja: Prof.Ass Kaltrina Kelmendi

Qëllimi kryesor i studimit është të analizojë faktorët që ndërlidhen me reziliencën te mësimdhënësit që kanë përjetuar viktimizim. Kështu, është testuar ndërlidhja në mes aftësive ndërpersonale siç janë dhembshuria dhe falja me mirëqenien subjektive dhe rritjen post-traumatik, që janë përdor si matje për reziliencë. Poashtu është eksploruar edhe ndërlidhja në mes mbështetjes sociale, mirëqenies subjektive dhe rritjes post-traumatike.

Punimi është ndarë 4 kapituj:

Kapitulli I: Hyrje

Në pjesën hyrëse të punimit është diskutuar rëndësia e këtij hulumtimi, duke marrë parasysh edhe mungesën e studimeve në kontekstin kosovar. Këtu diskutohen një varg sifidash që hasin mësimdhënësit në punën e tyre, prezenca e viktimizimit, dhe rëndësia e identifikimit të faktorëve që i ndihmojnë ata të jenë më rezilientë në përballje me këto sfida.

Hipotezat e studimit :

H1. Dhembshuria ka ndërlidhje pozitive me mirëqenien subjektive.

H2. Dhembshuria ka ndërlidhje pozitive me rritjen post-traumatike.

H3. Ekziston ndërlidhje pozitive midis faljes dhe mirëqenies subjektive.

H4. Ekziston ndërlidhje pozitive midis faljes dhe rritjes post-traumatike.

H5. Mbështetja nga miqtë ka ndërlidhje pozitive me mirëqenien subjektive.

Kapitulli II: Shqyrtim i literatures-perspektiva teorike

Në kapitullin e dytë, bëhet paraqitja e të gjeturave nga literatura, duke u bazuar në qëllimin e studimit. Fillimisht shqyrtohen disa nga sfidat dhe problemet e mësimdhënsve në kontekstin e shkollës. Pastaj definojnë variablat kryesore dhe shpjegohet më gjerësisht ndërveprimi mes faktorëve relevant, duke u mbështetur në modelin teorik të përdorur në këtë hulumtim, që njihet si Modeli i Portfolit të Reziliencës.

Kapitulli III: Metodologjia

Në këtë kapitull, përshkruhen atributet e pjesëmarrësve të këtij studimi, mënyra e kampionimit, instrumentet matëse të përdorura, dimensionin kohor, procedura e mbledhjes së të dhënave, konsideratat etike në lidhje me hulumtimet, pyetësin dhe pjesëmarrësit. Është përdorur metoda kuantitative (pyetësorë vetëraportues) dhe dizajni korrelacional për të parë ndërlidhjen mes variablave hulumtuese. Pjesë e mostrës së përdorur për studim, ishin 100 mësimdhënës të niveleve të ndryshme shkollore duke përfshirë shkolla fillore, të mesme të ulëta dhe të mesme të larta. Procedura e mostrimit është me mostër konviniente, me dizajn deskriptiv dhe korrelacional, duke testuar ndërlidhjen mes variablave hulumtuese.

Kapitulli IV: Rezultate, Diskutim, Limitime, Rekomandime, Referenca dhe Shtojcë

Te pjesa e rezultateve, përshkruhen rezultatet në mënyrë të përmbledhur, diskutohen të gjeturat në mbështetje të literaturës së shqyrtuar, po ashtu prezentohen edhe limitimet e studimit. Rezultatet e hulumtimit ilustrojnë një ndërlidhje pozitive të dy prej aftësive ndërpersonale siç janë dhembshuria dhe falja me mirëqenien subjektive dhe rritjen postraumatike dhe ndërlidhje në mes mbështetjes sociale nga miqtë dhe mirëqenies subjektive të mësimdhënësit që kanë përjetuar viktimizim. Në

interpretimin e të gjeturave diskutohen rezultatet nga studimi dhe jepen implikimet eventuale në praktikat që psikologët shkollor mund ti përdorin për ti ndihmuar mësuesit të tejkalojnë vështërsitë në mjedisin e shkollës dhe si ti përdorin asetet dhe burimet për rritjen e reziliencës.